REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 317/20
Datë/Datum. 21.05.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **616-19-1015-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Vazhdimi i rrugës B-Pjesa e dytë**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Grup i Operatorëve Ekonomik SABA BELCA Dega në Kosovë; SB CONSTRUCTION SH.P.K.; GURËBARDHI SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

MILLOSHEVË, OBILIQ
(Adresa)
OBILIQ — ***15000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*
049/396874
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

DRITON ETEMI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
sababelca.kosove@gmail.com
(Adresa elektronike)

21.05.2020
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

DEGA NE KOSOVE SABA BELČA MILLOSHEVE-OBILIQ

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie te kontratës.

Autoriteti kontraktues KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES për tenderin: Vazhdimi i rrugës B-Pjesa e dytë, ka publikuar këto njoftime:

- *Me daten 11.03.2019 Njoftim paraprak*
- *Me daten 03.12.2019 B05 Njoftim për Kontratë*
- *Me daten 17.12.2019 B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara*
- *Me daten 26.12.2019 Procesi i hapjes*
- *Me daten 04.03.2020 Njoftim mbi vendimin e AK*
- *Me daten 09.03.2020 Vendim sipas kerkeses per rishqyrtim Integral&Milenium*
- *Me daten 08.05.2020 Njoftim mbi vendimin e AK Rivlersim*
- *Me daten 13.05.2020 Vendim per 616 1015 511 Vazhdimi i rruges B*

Autoriteti kontraktues me datën 26.12.2019 në ora 14:00 ka bërë hapjen e ofertave, numri i tenderëve të pranuar 17, kriteri për dhënie të kontratës çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ Jo ☐

Ne me datë 12.05.2020 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK: KK Prishtinë për aktivitetin e prokurimit në fjalë, me datën 13.05.2020 na është refuzuar kërkesa për rishqyrtim, duke u thirrur se ankesa jonë është e pabazuar dhe se OE të propozuar për dhënie i plotësojnë kërkesat sipas AK. Bashkangjitur gjeni edhe vendimin e AK.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues **KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS** gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve ka vepruar në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092,

Shkeljet e dispozitave të LPP janë si mëposhtë:

Neni 7 i LPP-së – Barazia ne trajtim/jo diskriminimi
Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 i LPP-së - Kriteret për dhënien e kontratës

Neni 65 i LPP-së - Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve
Neni 69 i LPP-së - Aftësia teknike dhe/ose Profesionale
Neni 28 i RRUOP-së- Kriteret e Dhënies së Kontratës
Neni 41 i RRUOP-së- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne me datë 12.05.2020 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK: KK Prishtinë për aktivitetin e prokurimit në fjalë, me datën 13.05.2020 na është refuzuar kërkesa për rishqyrtim, duke u thirrur se ankesa jonë është e pabazuar dhe se OE të propozuar për dhënie i plotësojnë kërkesat sipas AK.

Në vijim po ju paraqesim faktet dhe dëshmitë me shkeljet e bëra nga ana e AK me rastin e vendimit për shpërblim me kontratë OE të propozuar, dhe me refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim.

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues **KUVENDI I KOMUNËS SE PRISHTINËS** gjatë procesit të vlerësimit të ofertave për këtë aktivitet të prokurimit me vleresimin e konsorciumit tonë të përbërë nga "SABA BELCA Dega në Kosovë; SB CONSTRUCTION SH.P.K.; GURËBARDHI SH.P.K si të pasuksesshëm ka vepruar në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

AK gjatë vlerësimit fillestar të ofertave e ka shpallur konsorciumin tonë si të suksesshëm, me vendimin e datës 04.03.2020, ku ky vlerësim është bërë konform Ligjit për Prokurim Publik. AK me datën 09.03.2020 publikon në sistem një dokument tjetër mbi Vendimin e AK pas kërkesës për rishqyrtim nga Grupi i Operatorëve Ekonomik Integral&Milenium, ku ceket se është aprovuar kërkesa për rishqyrtim nga ky grup, ku pastaj lënda do të kthehet në rivlerësim dhe pastaj me datën 08.05.2020 publikon dokumentin: "Njoftimin mbi vendimin e AK Rivlersim", ku OE ankues propozohet për kontratë. Pas marrjes së këtij vendimi nga ana jonë, menjëherë kemi kërkuar qasje në të dhënat e aktivitetit të prokurimit duke u bazuar në nenin 10 të Ligjit nr. 04/L-042.
Pasi na u mundësua qasja në dokumente shihej qartë se AK gjatë rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-042. AK gjatë rivlerësimit ka vlerësuar GOE Integral Shpk&Millenium Construction si ofertues të suksesshëm si dhe ofertën tonë si të pasuksesshme, ku me këtë ka bërë shkelje të shumë dispozitave të LPP.
Gjatë procesit të rivlerësimit komisoni për vlerësimin e këtij aktiviteti njësoj si gjatë vlerësimit fillestar jep rekomandim që kompaninë tonë ta shpërblej me kontratë pasi ishte e qartë se GOE Integral Shpk&Millenium Construction nuk i plotëson kriteret për dhënie të kontratës, mirëpo **AK më saktësisht Udhëheqësi i Departamentit të Prokurimit** jep

"VENDIM PËR REFUZIM TË REKOMANDIMIT PËR DHENJE TË KONTRATËS", me arsyetim se kompania ankuese i plotëson kriteret, osc për ndonjë arsye tjetër nga ana e tij. Këto dokumente i gjeni të bashkangjitura.

❖ **PRETENDIMET ANKIMORE PËR OE TË PROPOZUAR PËR DHËNIE**

PRETENDIMI ANKIMOR 1)

GOE i cili pas vendimit të fundit propozohet për shpërblim me kontratë, nuk plotëson shumicën e kritereve të dhëna nga AK. Ky konsorcium gjatë dy vlerësimeve nga komisioni vlerësues është eliminuar për arsyen: "Nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, (ndërtim i ultë) në vlerë minimale prej 3,000,000,00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë).

Kërkesa ka qenë:

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, (ndertim i ulte) ne vlere minimale prej 3,000,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).	**1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve.**

Ky konsorcium në ofertën e tyre ka përfshirë edhe kontrata të mirëmbajtjes dimërore që asesi nuk mund të jetë punë e ngjashme si dhe mirëmbajtjet verore. Poashtu këto mirëmbajtje hyjnë në kontrata për shërbime dhe jo kontrata pune siç është ky aktiviteti i prokurimit. Gjithashtu shihet se së bashku si konsorcium kanë më pak se 2 milion kontrata të natyrës së ngjajshme për 3 vitet e fundit. **AK më saktësisht Udhëheqësi i Departamentit të Prokurimit** ka marrë parasysh edhe disa pozicione të kontratës së mirëmbajtjeve për plotësimin e këtij kriteri mirëpo i ka anashkaluar pa i analizuar edhe shumë kontrata të cilat i ka përfunduar në fund të vitit 2016 duke kërkuar nga kompania situacionet e tyre dhe të shihet se a e plotësojnë kriterin për realizimin e këtyre kontratave brenda 3 viteve të fundit. Pra më saktësisht kontrata: **"Asfaltimi i rrugës në Merdar"** me vlerë prej **194,187.69 Euro** ka përfunduar me **20.12.2016**
"Asfaltimi i disa rrugëve në lagjen Ajeti në fshatin Sfeqël" me vlerë prej **63,952.67 Euro** e datës **19.12.2016**, e shumë kontrata të tjera si dhe vlen të ceket se gjatë qasjes në dokumente nuk na janë ofruar këto paramasa të kontratave. Njoftimi për kontratë ka qenë me datë: 03.12.2019 pra prej datës 03.12.2016 pranohen kontratat mirëpo për 16 ditë është e pamundur që OE të ketë përfunduar këto projekte me këtë vlerë totale.

Shembull konkret i kësaj kërkese ka qenë nga AK: Ministria e Infrastruktures në projektin: Rikonstruimi i rrugës Rajonale R115, Segmenti Prizren-Prevallë, ku AK ka derguar Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit për ofertën tonë për këtë qështje.

A mundeni ti dergoni procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve per te gjitha projektet te paraqitura ne liste sipas nr rendor:1, 4, 6, 7, 8, 9, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15. Keto projekte kane fillur para dt:25.07.2016 a mundeni te dergoni vetem vleren e puneve qe jan kryer pas dt:25.07.2016 deri me 25.07.2019 me deshmi si psh fatura, pagesa, ditar pune etj.

Pasi kemi dërguar dokumentet për sqarim tenderi, ne e kemi plotësuar këtë kriter mirëpo pastaj e njejta kontratat e mirëmbajtjes nuk i ka pranuar si punë të ngjajshme.

Ne listën e prezantuar nga "Saba Bellça" ka prezantuar 16 kontrata ne vlere prej 10,210,417.36 euro, Operatorit ekonomik nuk i janë pranuar kontrata me nr. 3 dhe 15 sepse nuk janë ne lëmin e kërkuar asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve. Vlera e pranuar është 9, 374,112.55 euro.

16	Mirembajtja vorore dhe d'merore e rrugeve ne Vranjska Banje	Vranjska Banje	15.02.2018	18.04.2019	637,638.71 €

Pra siç edhe po shihet nga dy Autoritete Kontraktuese po përdoren standarde të dyfishta.
Të dyja këto dokumente i gjeni poashtu të bashkangjitura.
Pra me të gjitha përpjekjet nga AK për të arritur vlerën e kërkuar shihet qartë se GOE nuk e plotëson këtë kriter.

Me këtë rast **AK më saktësisht Udhëheqësi i Departamentit të Prokurimit** nuk i ka respektuar dispozitat ligjore:
Neni 7 i LPP-së – Barazia ne trajtim/jo diskriminimi
Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 i LPP-së - Kriteret për dhënien e kontratës
Neni 65 i LPP-së - Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

2)

Kërkesa tjetër ka qenë:

2. Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme o Udhëheqës i punishtes - Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë – min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit (drejtimi konstruktiv). Udhëheqësi i punishtes duhet te ketë udhëhequr se paku 2 kontrata te natyrës se ngjashme. o Inxhinier i diplomuar i makinerisë (drejtimi i komunikacionit) min. 5 vite pervoje pune pas diplomimit. Duhet te ketë udhëhequr se paku 2 kontrata te natyrës se ngjashme. o Inxhinier i diplomuar i hidroteknikes me 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet te ketë udhëhequr se paku 2 kontrata te natyrës se ngjashme. o Inxhinier i	**2. CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit për udhëheqësin e punishtes. • Referenca per Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë per udheheqesin e punishtes. • Referenca per Inxhinier i dip. i makinerise (drejtimi komunikacion). • Referenca per Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë (drejtimi hidro). • Referenca per Inxhinier i dip. i elektroteknikes (drejtimi energjetike).**

diplomuar i elektroteknikes (drejtimi energjetike) me 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet te ketë udhëhequr se paku 1 kontrate te natyrës se ngjashme. o Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me tri vite përvojë pune pas diplomimit. o2 Teknike te ndertimtarise me dy vite përvojë pune pas diplomimit.	

Tek dokumentet e dorëzuara të personelit i cili do të jetë i angazhuar në këtë projekt nga kompania e shpërblyer me kontratë shihet se GOE Integral Shpk&Millenium Construction nuk plotëson gati asnjë nga këto kritere.

PRETENDIMI ANKIMOR 2) Për: a)Inxhinier i diplomuar i makinerisë (drejtimi i komunikacionit), b)Inxhinier i diplomuar i elektroteknikes (drejtimi energjetike), c)2 Teknike te ndertimtarise, **CV-të e të gjithë këtyre janë pa nënshkrim nga vet inxhinieri.**

PRETENDIMI ANKIMOR 3) Poashtu për: a)Inxhinier i diplomuar i hidroteknikes dhe b) Inxhinier i diplomuar i elektroteknikes (drejtimi energjetike) **nuk plotësohet kriteri për udhëheqje të kontratave të natyrës së ngjajshme pasi referencat e tyre janë për projekte të tjera.**

PRETENDIMI ANKIMOR 4) Për kërkesën: a)Inxhinier i diplomuar i hidroteknikes kompania e propozuar për shpërblim me kontratë ka lidhur kontratë mbi vepër me ing. Sokol (Veli) Xhafa, i cili në kohën kur është lidhur kjo kontratë ka qenë drejtor teknik për ndërmarrjen e ujësjellësit Prishtina, ndërsa tash është Kryeshef Ekzekutiv i KRU. Sidoqoftë **inxhinieri ka kontratë me orar të plotë në KUR ku e udhëheq këtë ndërmarrje dhe nuk mund të angazhohet në këtë projekt. Poashtu kontrata mbi vepër është vetëm kopje e jo origjinal.**

PRETENDIMI ANKIMOR 5) Për kërkesën a)Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me tri vite përvojë pune pas diplomimit, kompania në fjalë ka kontratë me një kompani gjeodezike për shërbime gjeodezike mirëpo **nuk ka kontratë të specifikuar për këtë aktivitet të prokurimit, si dhe ka kontratë me kompani gjeodezike e jo gjeodet si është kërkuar, përndryshe kompania gjeodezike do duhej të ishte pjesë e konsorciumit. Pra kontrata është poashtu para datës së njoftimit për kontratë.**

Me këtë rast **AK më saktësisht Udhëheqësi i Departamentit të Prokurimit** nuk i ka respektuar dispozitat ligjore:
Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 69 i LPP-së - Aftësia teknike dhe/ose Profesionale
Neni 41 i RRUOP-së- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

PRETENDIMI ANKIMOR 6)
Kërkesa tjetër ka qenë:

4. Operatori ekonomik duhet te ketë Baze për	**4. Kopja e Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjensioni për miniera dhe**

prodhimin e asfaltit, ne pronësi apo marrëveshje për furnizim me asfalt	**minerale. Në rastet kur O.E. ka marrëveshje për furnizim, O.E. duhet të dorëzoj edhe kopjen e marrëveshjes për furnizim.**
5. Operatori Ekonomik duhet te ketë Gurëthyes te licencuar ne pronësi apo marrëveshje për furnizim me zhavorr.	**5. Kopja e Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Në rastet kur O.E. ka marrëveshje për furnizim, O.E. duhet të dorëzoj edhe kopjen e marrëveshjes për furnizim.**
6. Operatori ekonomik duhet te ketë Bazë për beton nga një kompani e licencuar ose marrëveshje për furnizim.	**6. Kopja e Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Në rastet kur O.E. ka marrëveshje për furnizim, O.E. duhet të dorëzoj edhe kopjen e marrëveshjes për furnizim.**

Kompania e propozuar për shpërblim me kontratë nga AK më saktësisht nga Udhëheqësi i Departamentit të Prokurimit ka paraqitur disa kontrata për furnizim me asfalt, beton dhe zhavor nga disa kompani mirëpo **këto kontrata janë kontrata gjenerale të cilat janë përpiluar para Njoftimit për Kontratë për këtë aktivitet të prokurimit, pa e specifikuar aktivitetin e prokurimit për të cilin aplikon. Pra nuk e plotëson as edhe këtë kriter.**

AK me rastin e shpërblimit me kontratë GOE Integral Shpk&Millenium Construction ka bërë shkelje të këtyre dispozitave të LPP:

NENI 7 – BARAZIA NE TRAJTIM/JO DISKRIMINIMI

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Konsiderojmë se AK nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithe OE, por ka privilegjuar dhe shpërblyer me kontratë GOE Integral Shpk&Millenium Construction.

NENI 59 – EKZAMINIMI, VLERËSIMI DHE KRAHASIMI I TENDERËVE

1. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

2. Autoriteti kontraktues nuk mund të ndryshojë asnjë aspekt të një tenderi. Tenderuesit janë përgjegjës për të siguruar saktësinë e tenderëve të tyre.

3. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi që mund të korrigjohen pa pasur nevojë që të ndryshohet ndonjë material ose aspekt i tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk

mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

4. Përveç komunikimeve që janë autorizuar saktësisht nga nenet 34, 35 të këtij ligji si dhe paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni, asnjë komunikim, diskutim ose negociatë e çfarëdo lloji nuk mund të mbahen ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një operatori ekonomik, në lidhje me një tender të dorëzuar.

Konsiderojmë se AK ka konsideruar një tender të përgjegjshëm edhe pse nuk është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe duke shperblyer me kontrate GOE Integral Shpk&Millenium Construction.

NENI 60 – KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS

1. Autoriteti kontraktues do të përcaktojë në dosjen e tenderit nëse kontrata publike do t'i jepet:

1.1. tenderuesit që ka dorëzuar tender të përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

1.2. tenderuesit që ka dorëzuar tender të përgjegjshëm ekonomikisht më të favorshëm.

2. Nëse autoriteti kontraktues ka përcaktuar në dosjen e tenderit se kontrata publike do ti jepet operatorit ekonomik që dorëzon tenderin e përgjegjshëm ekonomikisht më të favorshëm, dhënia e kësaj kontrate do të bëhet vetëm në bazë të kritereve dhe peshës së tyre përkatëse të përcaktuar në dosjen e tenderit në pajtim me paragrafët 2. dhe 3. të nenit 52 të këtij ligji. 46

1. KRPP do të krijojë në kuadër të rregullave të prokurimit një procedurë të hollësishme të cilën autoritetet kontraktuese janë të obliguara ta respektojnë gjatë shqyrtimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. KRPP do të sigurojë që kjo procedurë të jetë (i) në pajtim me praktikat e mira ndërkombëtare, (ii) të sigurojë konkurrencë dhe transparencë adekuate, (iii) të zbatojë parimin e mosdiskriminimit, dhe (iv) të jetë në përputhje me të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij ligji.

Konsiderojmë se AK ka bërë shkelje të kësaj dispozite sepse konsorciumi jonë ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulet.

Poashtu edhe të shumë dispozitave të tjera mirëpo besojmë që këto janë të mjaftueshme që GOE të propozuar për dhënie ta eleminojnë si dhe ofertën tonë ta vlerësojnë si oferta me çmimin më të ulët të përgjegjshëm dhe të shpërblehemi me kontratë njejtë si gjatë vlerësimit fillestar.

Pra:
Kërkojmë që lënda të kthehet në rivlerësim, dhe pastaj nga AK të rekomandohemi për shpërblim me kontratë pasi që jemi OE i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Përgaditja e dosjes së tenderit,

Përgaditja e gjithë mekanizmit për ekzekutimin e kontratës, e shumë dëme tjera.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*